



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 1086/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Niman Baliu kandidat për anëtar të Asamble Komunale nga rradhët e Koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK dhe Lidhja Demokratike e Dardanis (LDD), Mitrovicë paraqitur kundër Qendrës së Numrimit të Rezultateve (QNR), për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit dhe manipulimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Niman Baliu kandidat për Asamble Komunale në Mitrovicë nga radhët e Koalicionit AAK- LDD.

**Arsyetim**

PZAP-i, më datë 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Niman Baliu është kandidat për Asamble Komunale në Zgjedhjet Lokale në Komunën e Mitrovicës i cili pretendon se nga të dhënat që i posedon nga vëzhguesit në teren kam pasur 147 vota, sipas KKZ-së kam 120 kurse sipas KQZ-se janë publikuar 124 vota, që donë të thotë se nuk ka përputhshmëri me vota.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP- konstatoi se pretendimet ankimore të Niman Baliut, janë të pabazuara, dhe të pa argumentuara, andaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i përgjithshëm dhe i pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse nga shkakun se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë të ankesës së parashtruar, me të cilat do të mund të administrohej lënda, ose do të mund të verifikohej vërtetësia e shkeljes së pretenduar. Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar shkeljet që janë cekur në ankesë, PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 1086/2013 më datën 06.12.2013



***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës Brenda njezetekatër (24) orëve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.